

**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES, DIVIZIONI PËR PRODHIMIN E
QYMYRIT, DEPARTAMENTI I SERWISEVE - Separacionit “B”**

RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

KEK- DPQ, Departamenti i Serviseve - Separacioni “B”



Maj, 2015

**KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES, DIVIZIONI PËR PRODHIMIN E
QYMYRIT, DEPARTAMENTI I SERVICEVE – Separacioni “B”**

**RAPORT
I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS**

KEK- DPQ, Departamenti i Serviceve - Separacioni “B”

Hartues i VNM-së:

Luljeta Kastrati, person i licencuar

KEK – DPQ, Dep. Inxhinjeringut
Separacioni “B”

Drejtori i Institutit “INKOS” sh.a
Dr.sc.Raif Bytyqi, inxh.dip.mjedisit

Maj, 2015

Përmbajtja

	Faqe
1.0. Hyrja	5
2.0. Baza Ligjore për hartimin e Raportit	6
2.1. Rregullativa Ligjore	6
2.2. Metodologjia e punës	8
3.0. Karakteristikat e lokacionit dhe mjedisit.....	9
3.1. Potencialet ekzistuese	10
3.2. Pozita gjeografike e lokacioni.....	11
3.3. Popullsia dhe Vendbanimet	20
3.4. Infrastruktura ekzistuese.....	21
3.5. Kushtet klimatike.....	22
3.6. Gjendja Hidrologjike	24
3.7. Flora dhe Fauna	25
3.8. Karakteristikat sizmike	26
3.9. Peizazhi	26
3.10. Ajri	27
3.11. Zhurma.....	29
3.12. Uji	30
3.13. Toka.....	31
3.14. Trashëgimia kulturore.....	33
3.15. Mbeturinat.....	34
4.0. Përshkrimi i procesit teknologjik te Impiantiti Separacioni“A”.....	37
4.1. Përshkrimi i procesit të prodhimit	37
5.0. Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve ne mjedis.....	48
5.1. Ndikimet ne ajër	48
5.2. Ndotja e tokës	49
5.3. Ndotja e ujit.....	49
5.4. Ndikimet ne peizazh.....	50

5.5. Ndikimet në boten bimore.....	51
5.6. Ndikimet popullatë... ..	51
5.7 Ndikimet ne zhurme	51
5.8. Ndikimet ne rast te aksidenteve ne mjedis	52
6.0. Masat për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve ne mjedis.....	53
6.1 Masat për mbrojtjen e ajrit	53
6.2. Masat për mbrojtjen e tokës	56
6.3. Masat për mbrojtjen e ujit	52
6.4. Masat e marrura për mbrojtje nga zhurma.....	58
6.5. Masat për mbrojtjen nga rreziqet aksidentale	59
7. Programi i monitorimit.....	59
8. Raportimi.....	60
9. Marrja e masave rehabilituese pas përfundimit të aktiviteteve	60
9.1. Objektivat e rikultivimit.....	60
9.2. Struktura përfundimtare e sipërfaqeve	61
9.3 Rikultivimi teknik.....	61
9.4. Rikultivimi Agroteknik.....	62
9.5. Rikultivimi biologjik.....	63
10. Monitorimi pas shfrytëzimit.....	63
11. Konkluzione.....	64

Shtojcat

1. H y r j e

Në kuadër të aktiviteteve për marrjen e Pëlqimit Mjedisor për veprimtarin e Separacionit “B”, KEK - KK Obiliq, ka angazhuar Institutin “Inkos” sh.a. me ekspert te licencuar nga MMPH, për hartim të Raportit për *Vlerësimin të Ndikimit në Mjedis*. Raporti i VNM-së paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për marrjen e pëlqimit mjedisor nga MMPH.

Me këtë synohet që të identifikohen dhe analizohen ndikimet në mjedis të tërë veprimtarisë së Separacionit “B” duke i parashtruar dhe ndërmarr masat e domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit në lokacionin ku vepron ky Impiant.

Duke analizuar karakteristikat e gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokacionin ku zhvillohet aktiviteti, si dhe karakteristikat e potencialeve përkatëse nga njëra anë, dhe karakteristikat inxhinieriko - teknike të punëve të cilat zhvillohen, nga ana tjetër, shtrohet nevoja për hartimin e këtij Raporti të VNM-së, ku do të përkufizohen të gjitha ndikimet relevante që mund të paraqiten në relacionin “Separacion “B”” dhe “mjedisi”, duke mos anashkaluar edhe ndikimet kumulative në rrethin dhe regjionin më të gjerë.

Nisur nga qëllimi paraprak dhe nga metodologjia e hartimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, ky raport bëhet me qëllim të përkufizimit të ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave të cilat do të jenë të nevojshme për tu marr për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative.

Me rastin e hartimit të Raportit janë marrë për bazë ndikimet në mjedis dhe aplikimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve, gjatë realizimit të procesit teknologjik dhe pas përfundimit të aktivitetit.

Pra me këtë raport do të ofrohen informata të mjaftueshme për zonën ku shtrihet Separacioni “B”, zonën e me të gjer dhe ndikimet e këtij aktiviteti në mjedis, si dhe masat mjedisore që ndërmerren gjatë ngritjes këtyre kapaciteteve, gjatë operimit dhe pas përfundimit të aktivitetit prodhues.

2. Baza ligjore për hartimin e raportit

Ne lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis – VNM është aprovuar dhe funksionon Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214, i cili përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM s.

Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214, ka për qëllim për të siguruar mundësimin e një vlerësimi të përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim që të parandalojnë dhe të zvogëlojnë apo mënjanojnë efektet negative në mjedis në kohën e duhur.

Analiza përfshin identifikimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti në mjedis gjatë funksionimit kontinuel të stacionit të karburanteve edhe at :

- Identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin
- vlerësimin e ndikimit në mjedis
- propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin e ndikimeve negative gjër në kufijtë e lejuar.

2.1. Rregullativa ligjore

a) Dokumentacioni normativ

Në lidhje me vlerësimin e ndikimit në mjedis, është aprovuar dhe funksionon Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214 i cili përcakton të gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim të VNM-së.

Ligji për VNM (Nr. 03/L-214) ka për qëllim për të siguruar mundësimin e një vlerësimi të përgjithshëm me ndërthurje të ndikimeve mjedisore të projekteve apo veprimtarive që do të realizohen me qëllim që të parandalojnë dhe të zvogëlojnë apo mënjanojnë efektet negative në mjedis në kohën e duhur.

Fusha e administrimit të mbeturinave në Kosovë rregullohet përmes Ligjit për mbeturina, Nr. 04/L-060. Qëllimi i këtij Ligji është mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe të mjedisit nga ndotja dhe rreziku nga mbetjet, përmes administrimit të mirëfilltë (të qëndrueshëm) të

mbeturinave, duke krijuar kushte për parandalimin dhe zvogëlimin e prodhimit të mbeturinave dhe rrezikshmërisë së tyre.

Ligjet dhe aktet nënligjore më të rëndësishme të aplikuara për hartimin e raportit të VNM-së për këtë kompani, janë shfrytëzuar :

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për VNM Nr. 03/L-214
- Ligji nr. 04/L-161 (16.05.3013) për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 03/L-160
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr.03/L-233
- Ligji për Kimikate Nr. 04/L-197
- Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012
- Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26
- Udhëzimi Administrativ Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat , parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor.

b) Dokumentacioni teknik

Dokumentacioni teknik bazë është siguruar nga ekspertët që udhëheqin aktivitetet në KEK-DPQ dhe Separacion, këto dokumente janë:

- Projekti Teknologjik i Impiantit i Separacionit “B”
- Certifikata e biznesit
- Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme
- Kopja e planit të parcelave,

Krahas parashikimeve themelore nga regullativat ligjore të cekura më lartë për nevoja të hartimit të raportit janë shfrytëzuar edhe regullativa tjera ligjore, duke përfshirë ligjet

aplikative të cilat tani janë në fuqi.

Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërshtuar për nevojat e hartimit të këtij raporti është shfrytëzuar edhe rregullativa relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse për mjedis si që është direktiva e VNM-së, si dhe Direktiva për mbeturinat.

2.2. Metodologjia e punës

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis të kompanisë së Separacionit “B” bazohet në:

a) Informatat themelore që nënkupton identifikimet siç janë:

- burimet themelore të ndikimeve në mjedis,
- popullata ekzistuese me karakteristikat demografike
- karakteristikat e dheut, topografia dhe peizazhi në lokacionin ku është e ndërtuar Separacioni “B”
- klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike,
- kualiteti i ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë,
- bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar.

b). Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve:

- madhësia dhe lloji i ndotjes,
- karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës,
- gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar ,
- vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë të materies ndotëse.

c). Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionin ku është e ndërtuar Separacioni “B” .

Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet kvantifikimit dhe vlerësimit të gjendjes ekzistuese. Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që ka të bëjë me potencial të shprehur ekologjik. Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjen aktuale të mjedisit në këtë lokacion.

3. Karakteristikat e lokacionit dhe mjedisit

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë themelore për hartimin e Raportit të Vlerësimit të ndikimit në Mjedis. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke shtrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren. Sektori energjetik është një ndër ndotësit më të mëdhenj të mjedisit në territorin e Komunës së Obiliqit. Niveli i lartë i emitimeve të gazrave nga termocentralet me përqendrim të madh të materieve acidike, pluhurit dhe vetëndezja e qymyrit, shkaktojnë ndotjen e madhe të ajrit. Mostrajtimi i ujërave nga procesi teknologjik, ujërave që rrjedhin nga minierat sipërfaqësore, gjendja jo e mire e rezervarëve dhe baseneve të ujërave fenolike dhe fenolit të koncentruar në zonën e gazifikimit dhe shpëlarja e tokës nga të reshurat atmosferike, në tërë zonën e KEK-ut, e cila gjatë kohës është ndotur me fenole, shkakton në masë të madhe ndotjen e lumit Sitnica, me theks të veçantë me fenole. Probleme shtesë janë edhe deponitë e hirit të cilat akumulojnë më shumë se 40 milionë tonelata hi, duke uzurpuar kështu rreth 242 ha tokë punuese, deponia nga TC “Kosova-A” dhe 150 ha deponia TC “Kosova-B”, si dhe gropat e hapura gjatë mihjeve sipërfaqësore për eksploatimin e thëngjillit. Aktivitetet minerare dhe gjenerimi i energjisë elektrike në të kaluarën, por edhe tani shkaktojnë ndotje të ashpër të mjedisit, ajrit, ujit, tokës, emitime të zhurmës dhe degradim të biodiversitetit natyror në territorin e Komunës. Ndotja e mjedisit karakterizohet edhe nga aktivitet urbane siç janë trafiku në komunikacion, menaxhimi joefikas i planifikimit hapësinor të territorit, trajtimi i ujërave të zeza-sanitare, si dhe menaxhimi jo i mirë i mbeturinave komunale.

3.1. Potencialet ekzistuese

Njëri nga elementet kyçe të hulumtimit të gjendjes ekzistuese të mjedisit është hulumtimi i potencialit ekzistues, e që konsiston në analizën e mirëfilltë të tërësisë hapësinore në zonën më të gjerë të kompleksit të KEK- DPQ, Departamenti i Serviseve - Separacioni “B”. Me qëllim që në bazë të pasojave të njohura të vlerësohen mundësitë e rrezikut ekologjik dhe në bazë të tyre të rekomandohen masat për zvogëlimin ose edhe eliminimin e tyre.

Karakteristikat e potencialit ekologjik përbëhen nga kombinimi i ndikimeve të ndërsjella të faktorëve natyror siç janë: toka, uji, ajri, reliefi, flora dhe fauna. Çdonjëri nga potencialet ekologjike në këtë mënyrë posedon funksionë të caktuara, që në esencë kanë rëndësi të dorës së parë analizën e problematikës së tërësishme të mbrojtjes së mjedisit.

Ndikimi i ndërsjellë i faktorëve të veçantë si dhe ndikimi i tyre në formimin e potencialit ekologjik dhe i funksioneve të tyre themelore me interes për analizën në fjalë, së bashku me kompleksin e marrëdhënieve të mundshme është paraqitur në figurën 1.




Fig. 1. Raportet themelore ndërmjet faktorëve natyrorë dhe potencialeve ekologjike

Në bazë të raporteve të paraqitura në figurën 1, është e qartë që faktorët natyror formojnë disa potenciale natyrore karakteristikat funksionale të të cilave duhen marrë parasysh gjatë valorizimit të ndikimit të qendrës për realizimin e aktiviteteve të kompanisë së Separacionit “B”.

3.2. Pozita gjeografike e lokacionit

Zona e KEK-ut gjendet mes luginës së lumit Sitnicë në lindje me lartësi mbidetare prej rreth +525 metra dhe një vargmal që zgjerohet në jug me lartësi mbidetare që shkon në +750 metra, kurse në anën perëndimore vazhdon të rrethohet me luginën e lumit Drenica me lartësi mbidetare të shtrirjes prej rreth +550 metra.

Lokacioni ku është ndërtuar “Separacioni B”, gjendet në Zonen Industriale të TC “Kosova B”, ne veri kufizohet me deponin e hirit TC “Kosova B”, ne perendim me lumin Sitnica, ne lindje me Obiliqin dhe ne Jug me zonen e perkufizuar te minierave dhe TC “Kosova A” .



Fig. 2. Pozita gjeografike e lokacionit Seperacioni “B” dhe TC “Kosova B”

Zona ku ndodhet Separacinoi “B” është e lokalizuar në komunën e Obiliqit rreth 10 km në perëndim të qytetit të Prishtinës. Komuna e Obiliqit shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës, në koordinatat 42o 41’ të gjerësisë veriore gjeografike dhe 21o 5’ të gjatësisë lindore gjeografike.

Është i vendosur në mes të rrafshit të Kosovës afër lumenjve Sitnicë dhe Llap, ka një pozitë të mirë gjeografike duke u kufizuar me: Prishtinën, Fushë Kosovën, Gllogocin,

Vushtrinë dhe Besianën. Territori i komunës së Obiliqit shtrihet në një sipërfaqe prej 105 km² dhe zë rreth 1 % të territorit të përgjithshëm të Kosovës. Këtë sipërfaqe e përbën një relief i ndryshëm me teren malor, sipërfaqe fushore dhe të rrafshët me tokë pjellore. Pjesa qendrore shtrihet rreth lumit Sitnica, ndërsa në perëndim reliefi ngritet në kodra e lugina të malit Qyqavica.




Fig. 3. Pozita e komunës së Obiliqit në Kosovë

Është qendër ekskluzivisht industriale me dy termocentrale dhe me rezerva të mëdha të thëngjillit të cilat shtrihen në mes të luginës së lumit Sitnicë dhe lumit Drenicë në një gjatësi prej rreth 32 km në drejtim veri-jug dhe një në gjerësi rreth 12 km.

Nga KEK, Divizioni I Qymyrit - Departamenti i Gjeodezisë Inxhinjerieke janë punaur të dhenat për parcelat në të cilat ka shtrirjen Separacioni “B”

1. Koordinatat e vijës përkufizuese të Separacionit në Kosova B
2. Regjistri i parcela sipas zonës kadastrale
3. Imazhe të situatës horizontale të Separacionit në Kosova B
4. Imazhe të parcelave të Separacionit në Kosova B
5. Regjistri i fletëve poseduese si pronë e KEK-ut
6. Harta të situatës horizontale të Separacionit në Kosova B në P=1:1000
7. Harta të parcelave të Separacionit në Kosova B në shkallë 1:1000

KOORDINATAT E KUFIJVE TË LINJËS PËRKUFIZUESE TË SEPARACIONIT NË KOSOVA B

1	7503952.28	4727499.21
2	7504082.35	4727549.73
3	7504093.21	4727570.19
4	7504169.59	4727636.19
5	7504190.39	4727668.22
6	7504340.15	4727764.72
7	7504533.68	4727890.87
8	7504549.31	4727908.30
9	7504561.35	4727923.48
10	7504572.30	4727940.98
11	7504583.91	4727956.33
12	7504570.44	4727977.78
13	7504578.27	4727988.87
14	7504551.77	4728025.79
15	7504538.79	4728061.03
16	7504497.06	4728096.28
17	7504450.05	4728115.03
18	7504422.26	4728124.71
19	7504226.98	4728014.75
20	7504121.89	4727955.58
21	7504083.87	4727932.14
22	7504053.88	4727894.96

23	7504048.17	4727869.26
24	7504034.32	4727850.70
25	7504016.62	4727838.14
26	7504003.05	4727828.43
27	7503952.09	4727787.32
28	7503918.84	4727786.17
29	7503871.86	4727791.89
30	7503846.73	4727799.02
31	7503812.15	4727816.36
32	7503786.28	4727822.44
33	7503775.55	4727819.48
34	7503790.34	4727788.54
35	7503778.00	4727779.70
36	7503784.54	4727775.34
37	7503787.38	4727772.24
38	7503783.16	4727768.34
39	7503803.02	4727753.99
40	7503776.39	4727730.46
41	7503745.81	4727702.24
42	7503929.90	4727523.79
43(1)	7503952.28	4727499.21

Regjistri i parcelave
dhe fletët poseduse në zonat kadastrale:
Z.K. Obiliq, Z.K. Leshkoshiq

Në vazhdim, në formë tabelore ju prezantojmë regjistrin e parcelave sipas zonave kadastrale.

Z.K. OBILIQ

Nr Ren	Parcela	Indikacioni	S				
			Kul	Klasa	Ha	Ari	m
1	370	KEK-ut	arë	3			
2	371	KEK-ut	arë	3			
3	372	KEK-ut	arë	3			
4	373	KEK-ut	arë	3			
5	374	KEK-ut					
6	375	KEK-ut	arë	3			
7	376	KEK-ut					
8	377	KEK-ut	arë	3			
9	378	KEK-ut	arë	3			
10	379	KEK-ut					
11	380	KEK-ut	arë	3			
12	381	KEK-ut					
13	382	KEK-ut					
14	383	KEK-ut					
15	384	KEK-ut	arë	3			
16	385	KEK-ut					
17	386	KEK-ut					
18	387	KEK-ut					
19	388	KEK-ut	arë	3			
20	389	KEK-ut	arë	3			
21	390	KEK-ut	arë	0			
22	391	KEK-ut	arë	3			
23	392	KEK-ut	arë	3			
24	393	KEK-ut	arë	4			
25	397	KEK-ut	arë	3			
26	398	KEK-ut	arë	3			
27	481	KEK-ut	arë	3			
28	1855	KEK-ut	arë	3			


NË Z.K. LESHKOSHIQ


Nr Ren	Parcela	Indikacioni	S					Vërejtje
			Kul	Klasa	Ha	Ari	m	
1	226	KEK-ut						
2	227	KEK-ut						
3	228	KEK-ut						
4	229	KEK-ut						
5	230	KEK-ut						
6	231	KEK-ut						
7	233	KEK-ut						
8	234	KEK-ut						
9	235	KEK-ut						
10	236	KEK-ut						
11	237	KEK-ut						
12	239	KEK-ut						
13	241	KEK-ut						
14	263	KEK-ut						
15	264	KEK-ut						
16	265	KEK-ut						
17	266	KEK-ut						
18	267	KEK-ut						
19	268	KEK-ut						
20	269	KEK-ut						
21	270	KEK-ut						
22	272	KEK-ut						
23	273	KEK-ut						
24	280	KEK-ut						
25	281	KEK-ut						
26	282	KEK-ut						
27	284	KEK-ut						
28	285	KEK-ut						
29	286	KEK-ut						
30	287	KEK-ut						
31	288	KEK-ut						
32	289	KEK-ut						
33	291	KEK-ut						
34	292	KEK-ut						
35	293	KEK-ut						
36	294	KEK-ut						

KEK, DIVIZIONI I QYMYRIT
DEPARTAMENTI I GJEODEZISË INXHINIERIKE
Tel: 038/501 401 2035



37	295	KEK-ut						
38	296	KEK-ut						
39	297	KEK-ut						
40	298	KEK-ut						
41	300	KEK-ut						
42	301	KEK-ut						





Plani i situacionit

Objekti i shpërndarës

Platoja e rezervareve

Objekti i shpërndarës

Objekti i makinerisë

Trafo 35 kv/06 kv

Objekti i shpërndarës "B"

1. Platoja e rezervareve - rezervari kryesor i naftes dhe derivateve te naftes
2. Objekti
3. Gypat shpërndarës
4. Ndërtesa shpërndarëse
5. Objekti i shpërndarës
6. Trafo 35 kv/06 kv
7. Ndërtesa shpërndarëse
8. Objekti i shpërndarës
9. Objekti i makinerisë

3.3. Popullsia dhe vendbanimet

Vendbanimet më të afërta nga zona e impiantit të Seperacioni “B” janë të lokalizuara në distancë prej 346 m, afërsisht distance e njete e ndane kete impiant edhe me Deponin e hirit dhe lumin Sitnica. Në tërë Komunën e Obiliqit gravitojnë 20 vendbanime duke përfshirë edhe vetë qytetin me dy vendbanime, pra janë 18 zona Kadastrale. Zonat Kadastrale jane: Hade, Babimoc, Bakshi, Breznicë, Çërkvena Vodice, Dobrosellë, Graboc i Epërm, Hamidi, Dardhishtë, Llazarevë, Leshkoshiq, Mazgit, Millosheva, Obiliq, Plemetin, Raskovë, Siboc, Shipitullë.

Tab.nr.1. Zonat katastrale, sipërfaqja, vendbanimet, nr. i popullatës dhe dendësia

Zonat kadastrale	Sipërfaqja km ²	Vendbanimet	Nr. i banorëve	Dendësia b/km ²
Obiliq	12.50	Obiliq	5648	487
		Obiliq i vjetër	1160	
Mazgit	6.38	Mazgiti i ultë	1441	452
		Mazgiti i lartë	1445	
Llazareva	2.10	Llazareva	429	204
Millosheva	7.35	Millosheva	2920	397
Bakshi	2.03	Bakshi	602	296
Raskovë	0.92	Raskovë	640	695
Bajmofc	8.04	Bajmofc	1680	209
Breznicë	14.32	Breznicë	1292	123
		Kozaricë	469	
Plemetin	5.73	Plemetin	2588	452
Hamidi	1.74	Hamidi	147	85
Sibofci	7.51	Sibofci	963	129
Grabocfi i Epërm	8.60	Grabocfi i Epërm	340	39
Shipitullë	2.96	Shipitullë	295	100
Hade	4.91	Hade	534	109
Mirash	2.32			
Lajthishtë	3.69	Lajthishtë	715	194
Palaj	7.11	Palaj	1463	206
Dardhishtë	6.64	Dardhishtë	1580	238
Totali	104.85	20	25629	246

Në shumicën e vendbanimeve kemi banim individual, kurse në Obiliq kemi banim të përzier kolektiv dhe individual. Vendbanimet që ndodhen afër qendrave urbane dhe atyre afër rrugëve vërehen tendencat e zhvillimit linear, duke i përcjellë vijat komunikative, për këtë arsye objektet e banimit, si dhe ato të bizneseve, shtrihen në formë vargore. Numri më i madh i objekteve të banimit është ndërtuar në hapësirat e rrafshëta urbane, që njëkohësisht është edhe hapësira më e banuar.

3.4. Infrastruktura ekzistuese

Komuna e Obiliqit është qendër e zhvillimit ekonomik të sektorit energjetik në Kosovë. Bartësit kryesorë të zhvillimit ekonomik në Komunën e Obiliqit sot janë prodhimi i energjisë elektrike në Termocentralet TC-A dhe TC-B, zhvillimi i aktiviteteve minerare në minierat e qymyrit, toka bujqësore e kategorisë I-IV dhe rruga magjistrale M2 në relacionin Prishtinë-Mitrovicë.

Rrjeti rrugor në Komunë ka një zhvillim shumë të volitshëm që i mundëson lidhje të shpejta me rrugë nacionale dhe rajonale.

- Rruga magjistrale M2 Prishtinë-Mitrovicë dhe rrugët rajonale;
- Obiliq-F. Kosovë;
- Obiliq-Milloshëvë-Besjanë;
- Obiliq-Palaj-Sibovc-Shipitullë-Grabovc-Drenas dhe rrugëve lokale (kryesisht të paasfaltuara).

Rrugët tjera, janë ato lokale, që lidhin vendbanimet përbrenda e zonës së KEK-ut me rrugët rajonale dhe qendrat e tyre urbane si dhe me vendbanimet më të afërta ndërkomunale.

Tab.nr. 2 Janë paraqitur rrugët, relacionet dhe gjatësia e tyre

Kategoritë e rrugëve	Relacioni	Gjatësia në km.
Magjistrale	Shkabaj-Mazgit-Milloshëv-Babimost	9
Rajonale	Obiliq-Milloshëv-Raskov	8
	Obiliq-Dardhisht	6
	Obiliq-Palaj-Lajthisht-Shipitull-Grabovc	14
	Total	28
Lokale	Obiliq (qyteza)	25
	Obiliq-Mazgit	4
	Obiliq-Plemetin	4
	Breznic-Kozaric	10
	Milloshëv-Raskov-Bakshi	5
	Llazarev-Subotiq	2.5
	Mazgit-Mazgit	3
	Lajthisht-Hamidi	3
	Lajthisht-Sibovc	5
	Total	61.5
Rrugët lokale të rendit të 4, të paasfaltuara		
	Brenda vendbanimeve	40

Dy linja hekurudhore kalojnë përmes territorit të Komunës. Njëra është linja Shkup-Fushë Kosovë-Mitrovicë me stacione në Dardhishtë, Obiliq dhe Plemetin, dhe e dyta është linja Fushë-Kosovë -Pejë, me stacion hekurudhor në Graboc. Termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B” janë të lidhura me rrjetë hekurudhor.

Infrastruktura ekonomike - Industria është një sektor shumë i rëndësishëm me aktivitetet e saj përcjellëse zë 8 % të territorit të komunës së Obiliqit. Po ashtu edhe përqindja e të punësuarve me 56.74% në këtë sektor, është më e madhe se sa në sektorët tjerë. Sigurisht që pjesa dërmuese e tyre janë të punësuar në energjetikë. Bartësit kryesor të zhvillimit në kete regjion sot janë termoelektranat, minierat e thëngjillit, toka bujqësore e kategorisë I – IV dhe rruga magjistrale M2 në relacionin Prishtinë – Mitrovicë.

3.5. Kushtet klimatike

Zona industriale e KEK-ut i nënshtrohet ndikimeve klimatike nga pellgu i Sitnicës dhe ai i Ibrit. Ka mikroklimë me specifikat e veta në të cilën kanë ndikuar proceset kimiko teknologjike si rrjedhojë e zhvillimeve nga industria energjetike.

Proceset e emisionit dhe imisionit në këtë zonë kanë shtrirë ndikimin e tyre në aerosolet dhe elementet e tjera klimatologjike. Për shkak të proceseve kimiko teknologjike, zona në të cilën ndodhet Seperacioni “B” ka një shkallë të lartë të lagështisë relative që variron nga 95% - 47%, përderisa kufijtë normal zakonisht janë prej 45 - 56%. Vlerat e reshjeve janë grumbulluar nga burimi i Institutit “INKOS”, të periudhës Skurt-Dhjetor, 2012 gjatë monitorimit për DPQ-në pikën matëse në oborrin e Institutit “INKOS”, e cila kjo pikë është mu në afërsi të Deponisë së Hirit gjë të cilën konsiderojmë si matje valide në përputhshmëri mbi reshjet.

Në grafik paraqitën vlerat mesatare mujore të reshjeve për periudhën e matjeve Shkurt-Dhjetor, 2012 për muaj, gjegjësisht për 11 muaj. Sasia më e vogël e reshjeve për vitin 2012 ka qenë mesatarja e muajit: VIII dhe IX^{të}. Ndërsa maksimalja mesatarja e muajit X dhe XI^{të}.

Fig.4.Grafiku - Reshjet shkurt-dhjetor 2012




Fig. 5. Grafiku - Reshjet shkurt - dhjetor 2012.





Figura në vijim paraqes shkallë të gjerë të temperaturave minimale dhe maksimale mujore, për vitin 2012. Nga figura shihet se mesatarja e temperaturës minimale,ka qenë gjatë muajit: Shkurt, -7.77°C . Ndërsa mesatarja e temperaturës maksimale ka qenë gjatë muajit Gusht: 32.16°C .

Fig. 6. Grafiku nr - Temperaturat min dhe max shkurt – dhjetor 2012



Sipas vlerave të dominimit të drejtimit të erës dhe qetësisë së tyre mund të konstatohet se qetësisë lajmërohen më së shpeshti kur nuk ka ndryshime të shtypjes atmosferike dhe

temperaturës me 32.7%. Prej erërave më së shpeshti është era frontale nga Veri-Verilindja me 20.3% nga Veriu me 19.4% dhe ajo që lajmërohet më pak është era në drejtim të Lindjes me 4 % dhe nga Jugu me 5%. Era nga drejtimi Verilindje më së shpeshti lajmërohet në pranverë e më rrallë dimrit. Qetësia më e madhe e erës vërehet në muajin Gusht e më së paku në muajin Prill. Shpejtësia mesatare më e madhe e erës është matur gjatë muajit Mars në shumë vite dhe ka vlerën 3.2 m/sekondë, ndërsa më e vogla në muajin Shtator 1.8 m/sekondë.




Fig. 7. Trëndafili Erës për Prishtinën. - Burimi: IHMK, 2004

3.6. Gjendja hidrologjike

Nga hulumtimet e shumta hidrogjeologjike është konstatuar se ujërat nëntokësore në regjionin ku shtrihet zona industriale e KEK-ut takohen shumë afër sipërfaqes në thellësi nga 3 – 5 m. Janë ujëra me nivel të lirë (freatike).

Është me rëndësi të theksojmë se gjatë punimeve për largimin e ujërave nga miniera e Mirashit dhe Bardhit, shpeshherë ka ardhur deri te shpërthimi i ujërave nëntokësore nga të çarat e shtresave të thengjillit. Me shpime dhe punime minerare është konstatuar se ujëmbledhësi kryesor i ujërave nëntokësore janë aluvionet në të dy anët e lumit Sitnicë, si dhe aluvionet e lumit Drenicë.

Komuna e Obiliqit përshkohet nga 3 lumenj : Sitnica, Drenica dhe Llapi. Lumi Sitnica, që rrjedh afër minierës së Mirashit, është i prekur rëndë prej aktiviteteve të minierës. Uji në lumenjtë dhe liqenet e tjera në komunë janë të ndotura në shkallë të ndryshme. Në komunën e Obiliqit janë 130.91 ha sipërfaqe ujore apo 1.25% e tërë sipërfaqes së territorit të komunës. Prej tyre janë: lumenj 61.22 ha, përroje 21.43 ha, jazë 2.49 ha, kanale 42.68 ha, mullinj 0.01 ha dhe kënetë 3.08 ha.

Nga vërshimet janë të rrezikuara vendbanimet: Obiliqi, Dardhishta, Palaj, Plemetini dhe Hamidija. Sipërfaqet e rrezikuara nga vërshimet shtrihen në të dy anët e lumit Sitnicë dhe Llap.




Fig. 8. Zonat e rrezikuara nga vërshimet

3.7. Flora dhe fauna

Në afërsi të fshatrave në Komunen e Obiliqit mund të gjendet vegetacion i vrazhdë. Biotopet natyrore gjenden afër lumit “Sitnica” dhe përfshijnë livadhet e lagështa, komunitetin e llojeve të bimëve barishtore, dhe llojet e drurit të ahut, lisit, shkurret etj., që gjenden në perëndim. Ndër shpendët e egër të malit e të fushës që ndeshen më shumë janë shqiponja e malit, petriti, grizhlat, sorrat, harabeli, kulumria, bufi, lakuriqi i natës etj. Ndër kafshët e egra që gjenden veçojmë dhelprën, lepurin, ujkun, derri i egër, buklën, iriqin, breshkën etj. Në ujërat e lumenjve e të kanaleve veçojmë rosat, patat, lejlekun, gjarpërinjtë e ujit, bretkosat, breshkat e ujit etj.

Nga dëmtimi i pyjeve po dëmtohen gjithashtu si flora ashtu edhe fauna e egër. Disa prej tyre janë në zhdukje e sipër si lepuri i egër, fëllënza e malit, shepka e malit, sidomos nga gjuetia e pakontrolluar, si në sezonin e gjuetisë ashtu edhe jashtë sezonit.



Fig. 9 . Pamje tipike e një lloji të fëllënzave në territorin e Komunës së Obiliqit

3.8. Karakteristikat sizmike

Territori i komunës së Obiliqit është në zonën sizmike prej 7 shkallëve të MCS deri në 8 shkallë të MCS. Për zonat mikro- sizmike nuk ka të dhëna. Zona sizmike kryesisht është ajo veri-lindore.

3.9. Peizazhi

Peizazhi në territorin e Komunës së Obiliqit, gjer me tani, nuk ka ndonjë peizazh që është shpallur i mbrojtur në bazë të legjislacionit në fuqi. Peizazhi natyror në një pjesë të territorit të Komunës në masë të madhe është i ndikuar nga minierat, deponitë e djerrinave, termocentralet dhe deponitë e hirit të “TC-A dhe TC-B”, kështu që kemi një pamje të ashpër të peizazhit natyror. Në pjesët tjera të territorit të Komunës kemi një pamje të mirë të peizazhit natyror. Në planet e ardhshme, zona e mihjeve ekzistuese, depozitat e hirit dhe depozitimet e djerrinës do të pastrohen, ri-kultivohen dhe mbillen, rrjedhë që vazhdimisht do të përmirësohet pamja vizuale e peizazhi natyror.

Në territorin e Komunës ekzistojnë vetëm disa monumente natyrore siç janë:

- Burim i ujit mineral në Graboc të Epërm;

- Burim/krua në qendër të fshatit Caravadicë (Palaj);
- Trung druri i vetëm bliri (*Tilia spec.*), i vjetër rreth 200 vjet, në lagjen Nicak (Sibovc) dhe;
- Grup trungjesh druri të bungut (3x *Quercus spec.*, 1x *Quercus cerris*), diku rreth 300 vjeçar, në lagjen e Megjuanëve (Sibovc).

3.10. Ajri

Zonat me ndotje më të madhe të ajrit në komunën e Obiliqit janë në rreze prej 8 km nga zona industriale dhe përfshin këto vendbanime: Dardhishtë, Obiliq, Mazgit, Plemetin, Hade, Palaj dhe Lajthishtë.

Procesi i prodhimit të energjisë elektrike nga termoelektranat ku bene pjese edhe seperimi i thengjillit përcillet me emision të pluhurit dhe gazrave siç janë: SO_2 , NOX , CO , CO_2 , H_2S , bloza, thërmiat ajrore sedimentet e metaleve të rënda (Zn, Cu, Cd, Pb, Ni, Cr, He, Mn, etj).




Fig. 10. Ndotja dhe degradimi i ajrit me SO_2




Fig.11. Ndotja dhe degradimi i ajrit me NO

Pluhuri total i depozituar dhe zhurma krijohet gjatë fazes së germimit, transportimit, seperimit, shkarkimit dhe deponimit të qymyrit, këto proqese ndikojnë në kualitetin e ajrit ambiental gjegjësisht rrezikojnë shëndetin e njeriut, floren, faunen dhe vlerat natyrore të mjedisit në DPQ.

Emisionet

Për shkak të dizajnëve projektuese të fundërruesve elektrostatik në TC Kosova B, pastaj mos ekzistimit të impianteve për reduktim të ndotësve si NO_x dhe SO₂, përmbajtjes së lartë të materieve inorganike në linjit dhe problemeve tjera gjatë procesit të djegies, emetimet e ndotjes në atmosferë janë më të larta se vlerat e lejuara kufitare.

Emitimi i grimcave

TC “Kosova A” pas ndërrimit të FE, me dizajn që siguron emisionet e grimcave nën kriterin e paraparë është bërë një përmirësim domethënës mjedisor.

Emetimi i dyoksidit të sulfurit SO₂

Emetimi i dyoksidit të sulfurit (SO₂) është i bazuar në përbërjen e qymyrit, kur sulfuri digjet, krijohet SO₂ dhe një pjesë e konsiderueshme lidhet me hirin fundërrues në kaldaj. Në TC Kosova A e as në TC Kosova B nuk janë të instaluar De-SO₂.

Emetimi i NO_x

Emetimi i NO_x shkaktohet prej djegies së azotit i cili është i përfshirë në qymyr dhe kryesisht nga prania e azotit në ajër. Oksidet e azotit formohen nga reaksioni kimik i azotit dhe oksigjenit të disocuar nga ajri, që përcillet në vatër. Për oksidimin e azotit

nevojitet një nivel i caktuar i temperaturës në vatër dhe një sasi e mjaftueshme e oksigjenit. Në TC Kosova A dhe B nuk përdoret asnjë metodë për reduktimin e emetimit të NO_x.

Emetimi i dyoksidit të karbonit

Dyoksidi i karbonit nuk shfaq efekte direkte të dëmshme për njerëzit dhe ekosistemin, por është një faktor domethënës në ngrohjen globale. Emetimi i CO₂ është proporcional me përmbajtjen e karbonit në karburante dhe kualitetin e derivateve të djegura. Nuk ka metodë të disponueshme komerciale për largimin e CO₂ prej burimit shkarkues dhe opsioni më i mirë për reduktimin e emetimit të CO₂ është rritja e efikasitetit të pajimeve dhe djegia sa më racionale e derivateve apo ndryshimi në derivate me një përmbajtje më të vogël të karbonit (për shembull prej linjtit të kalohet në përdorimin e gazit natyral).

Emetimi i CO

Procesi i djegies është i përcjellur me emetimin e monoksid të karbonit. Ky emetim shkakton rritje e konsumimit të derivateve dhe është si pasojë e procesit të keq të djegies-procesi jo i plotë i djegies.

3.11. Zhurma

Burimet për krijimin e zhurmës në Zonën Industriale të KEK-ut janë:

- Zhurma që krijohet nga aktivitetet minerare dhe transporti i qymyrit, pajisjet për eskavim dhe transport dhe shiritat bartës;
- Rruga që qon në miniera, kryesisht shkaktohet nga kamionët për miniera dhe ata që bartin mbeturina, por edhe nga transporti i punëtorëve;
- Shiritat transportues të qymyrit;
- Zhurma operative e “TC A”, si termocentral;
- Zhurma në termocentral vjen nga shiritat bartës, pajisjet thërmuese, ndezësit, turbinat, gjeneratorët, ventilatorët, kompresorët, pompat, kullat ftohëse dhe oxhaqet;
- Operimi i lokomotivave të KEK-ut;

Niveli i zhurmës, si për të punësuarit ashtu edhe për banorët në brendësi të zonës energjetike, konsiderohet aspekt kyç që duhet trajtuar në kuadër të standardeve të BE-së dhe praktikave më të mira.

3.12. Uji

Në territorin e Komunës ekzistojnë tre lumenj natyror që janë: “Sitnica”, “Drenica” dhe “Llapi”. Si dhe një kanal artificial që është Kanali Iber-Lepenc, i cili vjen nga liqeni akumulues i Ujmanit nga rrjedha e lumit “Iber”. Lumi “Sitnica” përshkon territorin e Komunës nga jugu në veri dhe është ujëmbledhësi i 80 % të ujërave në drejtim të veriut. Lumi “Sitnica” derdhet në lumin “Ibër” në Mitrovicë. Lumi “Drenica” rrjedhë në perëndim dhe derdhet në lumin “Sitnicë” para hyrjes në jug në territorin e Komunës. Lumi “Llap” rrjedhë në lindje, i cili derdhet në lumin “Sitnicë” në veri të territorit të Komunës. Lumi “Sitnicë” është lumë fushor me pjerrtësi të vogël, me shtrat të gjerë, të cektë dhe me gjarpërime, veçohet me prurje të vogla vjetore të ujit. Gjatë stinës së verës nuk ka prurje më të madhe se 2.5 m³/s, kurse gjatë stinës së dimrit dhe në pranverë, kur bëhet shkrirja e bores, kjo prurje është 15 herë më e madhe, përkatësisht 37.5 m³/s. Gjatë prurjeve të mëdha të ujit, lumi “Sitnica” del jashtë shtratit dhe përmbytë sipërfaqe të tokave punuese për rreth, duke i shkaktuara dëme të mëdha bujqësisë. Vetë fusha e mihjeve mbulon gjashtë zona ujëmbledhëse të zonave më të vogla ujore; katër prej tyre që rrjedhin në drejtim të lumit “Sitnicë” në lindje dhe dy në drejtim të lumit “Drenica” në perëndim. Përgjatë lumit “Sitnicë” shtrihet një fushë, që përmbytet me ujë në sezonin e reshjeve të mëdha, në të cilën gjendet lokacioni i zonës industriale ku janë vendosur dy (2) blloqet e TC “Kosova B”. Lumi “Sitnicë” është i ndotur nga shkarkimet në rrjedhën e mesme të tij nga shkarkimet urbane, e përveç tyre edhe nga efluentët nga termocentralet dhe mihjet e KEK-ut, të cilat shkarkohen direkt, pa ndonjë trajtim adekuat, si dhe rrjedhat e ujërave nga deponitë e hirit. Përveç këtyre, lumenjtë pranojnë përmbajtje të madhe të materieve organike, pasi që nuk ka fare ose fare pak trajtim të ujërave të zeza. Të dhënat e përpiluara së mbi pikat e shkarkimit dhe marrjes së mostrave të cilësisë së ujit tregojnë që uji i lumit “Sitnicë” duhet kategorizuar si Ujë i Klasës IV, sipas sistemit të klasifikimit (pra, “ujë që mund të përdoret vetëm pas një trajtimi special”) dhe është larg nga standardet evropiane të cilësisë.




Fig. 12. Shkalla e ndotjes së lumenjve në Komunë

Infrastruktura e rrjetit të kanalizimit të ujërave të ndotura, e cila përfshin tubacionet kryesore, d.m.th. primare, sekondare, pusetat etj., është e projektuar dhe ndërtuar gjatë viteve 1970, 1985, 1990, 2000 - 2011, e cila ka përfshirë fillimisht pjesën urbane të qytetit. Rrjeti i kanalizimit përveç grumbullimi të ujërave të ndotura urbane grumbullon edhe ujërat atmosferike. Shkarkimi i ujërave të ndotura bëhet në tetë (8) pika shkarkuese pa trajtim paraprak në lumin “Sitnicë”. Derdhja e ujërave të zeza-sanitare nëpër sipërfaqe të hapura në ato vendbanime që nuk kanë qasje në rrjet të kanalizimit dhe shkarkimi i ujërave të zeza-sanitare të pa trajtuara në lumenjtë “Llap”, “Drenicë” dhe “Sitnicë”, janë probleme që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme.

3.13. Toka

Komuna e Obiliqit është Komuna më ndikimin me të madh nga gjenerimi i energjisë elektrike, mihjes sipërfaqësore, deponimeve të hirit dhe të djerrinës, si dhe vendbanimeve, që ka nën shfrytëzim dhe pronësi private 56 % ose me 5.862 ha të sipërfaqes së tokës, kurse nën pronësi dhe menaxhim publik janë 4.620 ha ose 44%, nga e cila KEK-u posedon 15 %. Shfrytëzimi i tokës në territorin e Komunës ka rëndësi të madhe dhe nënkupton destinimin e sipërfaqeve apo llojin e nxënies së hapësirës, gjegjësisht të sipërfaqeve tokësore nën renditje të sektorëve nga të cilët shfrytëzohen ato.

Në kuadër të territorit të Komunës është me rëndësi të dihet pjesëmarrja e pronësisë së tokës, në vijim në formë tabelare po e paraqesim përdorimin dhe destinimin e tokës.

Shfrytëzimi tokës	Sipërfaqja	(%)
Zona me potenciale bujqësore	6852 ha	65.4
Zona me pyje	1153 ha	11
Zona e banimit/vendbanimet	833 ha	8
Prona ujore	96 ha	0.9
Prona rrugore	247 ha	2.4
Zona e minierave në shfrytëzim	838 ha	8
Deponitë e hirit nga “Kosova A dhe B”	272 ha	2.5
Zona industriale - “TC Kosova A dhe B”	191 ha	1.82
Gjithsejtë:	10482 ha	100

Në zonën ku shtrihet Separacioni “ B” s, sipas Hartes pedologjike të Kosovës e punuar nga Instituti “Jerosllav Çerni” Beograd 1974 dominojnë tokat Aluviale. Këto toka janë gjenetikiisht të pa zhvilluara – toka në fazën e zhvillimit të vet, formohen në ultësira lumenjsh e përrenjsh me depozitimin e materialit të hedhur më ujërat rrjedhëse. Tokat aluviale për shkak të vetive fizike dhe kimike që posedojnë konsiderohen si toka shumë të mira për zhvillimin e prodhimtarisë bujqësore.

Ndotja e dheut- Ekziston ndotje e dheut në zonën e ish-objekteve industriale energjetike, në lokacionin në afërsi të “TC Kosova A”, depozitimi i mbetjeve toksike të prodhimit (mbetjeve fenolike dhe blozës) në deponinë e hirit të “TC Kosova A”, si dhe punimeve të vjetra minerare nëntokësore. Burimet kryesore potenciale të identifikuar të kontaminimit të dheut dhe ujërave nëntokësore janë:

- Derdhjet e substancave vajore dhe materieve tjera kimike, veçanërisht në lokacionet e stabilimenteve të mëhershme të gazifikimit, dhe azotikut;
- Shirat acidike, aerosolet dhe grimcat e suspenduara nga termocentralet, aktivitetet e mihjeve, si dhe deponitë e hirit (më parë ka pasur edhe depozitime të ndotësve nga impiantet e vjetra të gazifikimit dhe azotikut);
- Deponimi i mëparshëm dhe aktual i mbeturinave në deponi të hirit, në veçanti në deponinë e hirit të “Kosovës A” dhe në minierën e vjetër (deponia sanitare rajonale) dhe;
- Shkarkimet e ujërave industriale dhe të zeza të pa trajtuara.

3.13. Trashëgimia Kulturore

Në zonën ku shtrihet Separacioni “B” nuk ka pasur diversitet të pasur kulturor, ndërsa në regjionin e gjere te Obiliqi ekzistojnë disa objekte të trashëguara nga e kaluara historike dhe si të tilla shërbejnë si objekte turistike

Tab.nr. 3. Lokacionet e pronave kulturore

Vendbanimet	Monumentet e trashëgimisë kulturore-historike dhe kultit fetar
Obiliq	Monumenti i martirëve të lirisë Monumenti nga Lufta e Dytë Botëror. Xhamia Kisha në Obiliq Shtëpia e Kulturës (KEK) Shtatorja e atdhetarit Aziz Zhilivoda Busti i komandantit Adem Jashari Busti e dëshmorit të kombit Fahri Fazliu
Obiliq i vjetër	Xhamia
Mazgit i ultë	Monumenti i Ferid Currit Xhamia
Mazgit i epërm	Monumenti i luftëtarëve të Kosovës Tyrbja e Sulltan Muratit Tyrbja e Bajraktarit (Gazi Pashës)
Hade	Monumenti i martirëve të UÇK-së Xhamia në Hade
Hamidi	Xhamia (nga shek.-XVIII) Shtëpia Muze në Hamidi Lapidari i lirisë
Sibovc	Xhamia Varrezat e dëshmorëve
Grabovc	Xhamia Mulliri i ujit (i Hysenajve) Mulliri i ujit (i Behramajve) Pllakë përkujtimore e dëshmorit Fejzullah Graiqevci Pllakë përkujtimore e dëshmorit Faik Mjeku
Shipitullë	Monument i luftës (UÇK)
Milloshvë	Xhamia (nga shek.-XVIII) Shtëpia e kulturës
Bajmovc	Kisha ortodokse
Breznicë	Xhamia
Plemetinë	Qendra rinore Kisha ortodokse
Dardhishtë	Xhamia
Bakshi	Xhamia
Kozaricë	Xhamia

3.12 Mbeturinat

Në zonën industrial te KEK-ut, sipërfaqe të mëdha të tokës janë të mbuluara me depozitime të djerrinës nga aktivitetet e mëparshme të mihjes, deponitë e hirit nga termocentralet , mbetje kontaminiuese te ngurta te lengeta dhe deponi sanitare. Ne zonen ku shtrihet Separacioni “B” dominojnë mbeturinat e ngurta te cilat verehen gjate tere vijes transportuese te qymyrit e veqanarisht ne lokacionin ku behet thermimi i qymyrit. Mbeturinat në sasi më të mëdha ne KEK janë produktet e djegies të linjitit-hiri, deponia pasive e hirit e TC B e cila ndodhet afer Separacionit “B” së bashku me djerrinat dhe lagunën kapin një sipërfaqe prej rreth 234 ha. Tani zgurra dhe hiri fluturues prej TC “A&B” transportohen në mënyrë hidraulike në vendet e boshatisura te S. Mirash..

Vajrat me përbërje të BPK (bifenileve të polikloruara) Sa i përket problemit ,edhe me tej, mjaft të aktualizuar të pajisjeve dhe mbeturinave me përbërje të bifenileve të polikloruara (PCB), Konsulenca (Lavalin nga Kanada) e angazhuar nga BB, bazuar në rezultatet e inventarizimit të bërë në KEK, është përfshirë në punën e ndërmarrjes për përmbylljen e këtij inventarizimi, rishikimin e të dhënave në dispozicion, të dokumentacionit dhe raporteve në lidhje me pajisjet përkatëse në KEK dhe më gjerë.

Materiet radioaktive Në KEK është bërë inventarizimi i pajisjeve me mbushje radioaktive dhe eshte vendosur linja bashkëpunimi me MMPH dhe jane në përpjekje të përbashkëta për gjetje e mundësive për trajtim të tyre.

Vajrat Brenda hapësirave të KEK-ut janë të deponuara sasi të konsideruara të vajrave mbeturinë.

Asbesti Sipas informative që disponojmë KEK-u nuk posedon materiale të asbestit në përdorim. Prezenca e pakta të asbestit megjithatë nuk mund të përjashtohen sipas personelit të centralit.

Mbeturinat metalike dhe të tjera KEK-u posedon mbeturina të klasifikuara të metaleve, duke përfshirë çelikut, hekurin, aluminin, kromin dhe bakrin së bashku me gomën e hequr nga shiritat transportues të qymyrit dhe djerrinës. Materialet e lartpërmendura janë kryesisht të lokalizuara në hapësirat e mihjes dhe gjenerimit në Obiliq ku menaxhohen nga termocentralet dhe MS nëpërmjet kompanive të licencuara për trajtimin e mbeturinave metalike dhe vajrave mbeturinë.

Një problem tjetër mjedisor mjaft i shprehur me vite të tëra në Zonën industriale të KEK-ut, paraqet Deponia urbane regjionale e mbeturinave e vendosur në Mirash. Për të përmirësuar këtë gjendje shumë të rëndë mjedisore dhe për të evituar infektimet dhe epidemitë e mundshme, por edhe zbutjen e dëmeve ekologjike, kërkohet nga autoriteti kompetent të merren masa shumë të shpejta në këtë drejtim, meqenëse kjo Deponi nuk është në përgjegjësi menaxhuese të KEK-ut.

Projekti Teknologjik i Impiantit i Separacionit “B”

PARAMETRAT TEKNIK DHE TEKNOLOGJIKË

TE SEPARACIONIT

SEPARACIONI,, B‘

Gjendja e Projektuar

Për furnizimin me qymyr të fazës së I-rë të TC - B, 2 x 340 MW, është bërë dimensionimi i transportit dhe pajisjeve thërmuese për kapacitetin $Q = 6\,000\,000$ t/vit për punë në 3 ndrrime, 14 h/ditë dhe 300 ditë pune në vit.

Transporti i qymyrit nga M.S. bëhet me dy Sisteme të SHT. me kapacitet maksimal $Q_{\max} = 1800$ t/h, (për një sistem) dhe kapaciteti i Thërmitores është projektuar për kapacitetin $Q_{\min} = 1800$ t/h.

Me qëllim të përvetësimit të ndikimit të faktorve të ndryshëm, pajisjet thërmuese janë projektuar për kapacitet $Q_{\max} = 2000$ t/h.



Imazh: SeparacioniB.

Karakteristikat teknike të pajisjeve:

-Poz. 7a1 ; a2 ; b1 ;b2- Thermitoret me çekiça dhe cilindra

Thermuesja me çekiç dhe cilindra

Tipi i thërmueses: Tip 1137 $\Phi 1600 \times 2200$ mm,

Kapaciteti i thërmueses $Q = 1100$ t/h,

Elektromotori me fuqi $P = 750$ KW, $n = 590$ rr/min.

Granulimi dalës: $-30 + 0$ mm.

-Shiritat transportues 9a

Gjerësia e shiritit $B = 1600$ mm,

Gjatësia e transporterit $L = 108.65$ m.

Lartësia e ngritjes $H = 6.4$ m

Kapaciteti i nevojshem $Q = 1800$ t/h

Qymyri – $30 + 0$ mm, $\gamma = 0.75$ t/m³

Shpejtësia e transporterit $v = 3.14$ m/s

Këndi i ruleve anësore $\beta = 30^0$

Elektromotori $P = 2 \times 75$ KW; 0.4 kv; $n = 1485$ rr/min

-Shiritat transportues; 9b.

Gjerësia e shiritit $B = 1600$ mm,

Gjatësia e transporterit $L = 108.65$ m.

Lartësia e ngritjes $H = 6.4$ m

Kapaciteti i nevojshem $Q = 1800$ t/h

Qymyri – 30 + 0 mm,	$\gamma = 0.75 \text{ t/m}^3$
Shpejtësia e transporterit	$v = 3.14 \text{ m/s}$
Këndi i ruleve anësore	$\beta = 30^0$
Elektromotori	$P = 2 \times 75 \text{ KW}; 0.4 \text{ kv}; n = 1485 \text{ rr/min}$

-Shiritat transportues 14a.

Gjerësia e shiritit	$B = 1600 \text{ mm},$
Gjatësia e transporterit	$L = 151 \text{ m}.$
Lartësia e ngritjes	$H = 7.0 \text{ m}$
Kapaciteti i nevojshem	$Q = 1800 \text{ t/h}$
Qymyri – 30 + 0 mm,	$\gamma = 0.75 \text{ t/m}^3$
Shpejtësia e transporterit	$v = 3.14 \text{ m/s}$
Këndi i ruleve anësore	$\beta = 30^0$
Elektromotori	$P = 2 \times 75 \text{ KW}; 0.4 \text{ kv}; n = 1485 \text{ rr/min}$
Reduktori polak	$2 \times 75 \text{ KW}.$
Raporti i transmisioniti	$i = 20$
Diametri i tamburit veprues	$Dt = \Phi 800 \text{ mm}.$

-Shiritat transportues 14b.

Gjersia e shiritit	$B = 1600 \text{ mm},$
Gjatësia e transporterit	$L = 151 \text{ m}.$
Lartësia e ngritjes	$H = 7.0 \text{ m}$
Kapaciteti i nevojshem	$Q = 1800 \text{ t/h}$

Qymyri – 30 + 0 mm, $\gamma = 0.75 \text{ t/m}^3$

Shpejtësia e transporterit $v = 3.14 \text{ m/s}$

Këndi i ruleve anësore $\beta = 30^0$

Elektromotori $P = 2 \times 75 \text{ KW}; 0.4 \text{ kv}; n = 1485 \text{ rr/min}$

Reduktori polak $2 \times 75 \text{ KW.}$

Raporti i transmisioniti $i = 20$

Diametri i tamburit veprues $D_t = \Phi 800 \text{ mm.}$

- Shiritat transportues. 16_A, 16_B

$B = 1400 \text{ mm,}$

$v = 4.287 \text{ m/s,}$

$L = 509.27 \text{ m,}$

$H = + 12.72 \text{ m,}$

$\beta = 30^0$

$\beta_1 = 15^0$

$\gamma = 0.75 \text{ t/m}^3$

$\alpha = 10^0$ (te stacioni ngasës)

Fuqia e instaluar $N = 315 \text{ kW}$

- Shiriti transportues. 15_A

$B = 1400 \text{ mm,}$

$v = 4.45 \text{ m/s,}$

$L = 81.087 \text{ m,}$

$$H = + 6.121 \text{ m},$$

$$\beta = 30^0$$

$$\beta_1 = 15^0$$

$$\gamma = 0.75 \text{ t/m}^3$$

$$\alpha = 4^0 19' (\text{ te stacioni ngasës})$$

$$\text{Fuqia e instaluar } N = 110 \text{ kW}$$

- Shiriti transportues. 15_B

$$B = 1400 \text{ mm},$$

$$v = 4.55 \text{ m/s},$$

$$L = 9.0 \text{ m},$$

$$H = 0 \text{ m},$$

$$\beta = 30^0$$

$$\beta_1 = 15^0$$

$$\gamma = 0.75 \text{ t/m}^3$$

$$\alpha = 0^0$$

$$\text{Fuqia e instaluar } N = 30 \text{ kW}$$

$$K = 1$$

- Shiriti transportues. 17_A

$$B = 1400 \text{ mm},$$

$$v = 4.45 \text{ m/s},$$

$$L = 72.037 \text{ m},$$

$$H = + 9.4 \text{ m,}$$

$$\beta = 30^0$$

$$\beta_1 = 15^0$$

$$\gamma = 0.75 \text{ t/m}^3$$

$$\alpha = 8^0 27' (\text{ te stacioni ngasës})$$

Fuqia e instaluar $N = 30 \text{ kW}$

$$K = 0.97$$

- Shiriti transportues. 18_R

$$B = 1400 \text{ mm,}$$

$$v = 4.55 \text{ m/s,}$$

$$L = 9.0 \text{ m,}$$

$$H = 0 \text{ m,}$$

$$\beta = 30^0$$

$$\beta_1 = 15^0$$

$$\gamma = 0.75 \text{ t/m}^3$$

$$\alpha = 0^0$$

Fuqia e instaluar $N = 30 \text{ kW}$



SHPJEGIM PER VENJE NE PUNE RROTEN PUNUESE PER KOSOVE


Ngarkuesi i kombinuar i rrotës punuese

Udhëzime të përgjithshme


Efekt i punës-Ngarkesa	1 800 t/h
Efekt i punës-Grumbullimi	1 800 t/h
Malli i kërkuar	qymyr 1 mbyllt
Madhësia e thepave	0 – 30 mm
	30 – 50 mm (max.20%)
Numri i rrotullimeve	5,89 U/min
Numri i zbraziqeve	47 1/min
Numri i kovave	8
Përmbajtja e kovës	660 l
Përmbajtja e hapësirës së rrethit	220 l
Shpejtësia e shiritit të shtyllës transferzale	3 m/s
Gjersia e shiritit	1 400 mm
Shpejtësia e luhatjeve bazuar në	
mesin e rrotës punuese	6 – 33,5 m/min
Shpejtësia e ngritjes së shtyllës transferzale	
bazuar në mesin e rrotës punuese	3,52 m/min
Shpejtësia e uljes	3,75 m/min
Shpejtësia e lëvizjes	19,8 m/min
Rregullimi i përgjithshëm	
Ngarkuesi i kombinuar i rrotës punuese	B40.00400-0009
Shinat e lëvizjes	S 49
Shpejtësia e rrës në punë dhe	20 m/s
jashtë saj	36 m/s


Vepra-Nr. : M.A.N. 680 920
 Kodi: Kosovorad
 Viti i projektimit: 1979
 Vendndodhja: Rudarsko Energetsko-Hemijsko Metalurški
 Kombinati "Kosovo"
 Marsala Tita 36 – 38000 Pristina Jugosllavien


**SKEMA TEKNOLOGJIKE E PËRGATITJES DHE TRANSPORTIMIT
TË QYMYRIT NË SEPARACIONIN "KOSOVA - A"**



SKEMA TEKNOLOGJIKE E THËRMIMIT DHE
DEPONIMIT TË QYMYRIT NË SEPARACIONIN "B"







5. Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis

Në bazë të analizave vizuale vërehen ndikimet negative në mjedisin punues për punëtorët që punojnë në impiantin Separacioni “B” si dhe mjedisin jetësor për komunitetin për rreth.

Gjatë transportit, separimit dhe deponimit të qymyrit shkaktohet rritja e emisionit të materieve ndotëse, sidomos vërehet shkallë me e lartë e emitimit gjatë stinës së verës, që e vështirëson punën e punëtorëve në këtë impiant.

5.1. Ndikimet në ajër

Në aktivitetin e pajisjeve për transportin, separimin-klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit, si ndikim negativ në mjedis shprehet në ajër. Hartuesi i këtij raporti vlerëson se nga teknologjia për kryerjen e aktiviteteve të lartë cekura lirohen grimcat e mëdha të pluhurit të cilat tentojnë të gravitojnë për shkak të peshës së tyre në drejtim të tokës, dhe depozitohen në afërsi të shiritave transportues për transportimin e qymyrit, thërrmueseve për thërrmimin e qymyrit dhe pajimet përcjellëse për transportimin dhe depozitimin e qymyrit, kurse pluhurat me përbërje të elementeve kimike që posedon vetë lëndë minerale, thërmitë më të vogla të cilat i bartë ajri për shkak të reliefit dhe kushteve tjera mjedisore gravitojnë në distanca më të largëta, kjo situatë e përshkruar, kishte me qenë pa përdorimin e masave për zvogëlimin e pluhurit.

Ndotësit janë kryesisht pluhurat që barten me anë të erës .

Gjatë realizimit të procesit teknologjik për transportin, thërrmimin, separimin, klasifikimin dhe deponimin e qymyrit, ndikime negative në ajër ndodhin edhe nga:

- Pluhurat të cilët lirohen nga shiritat transportues për transportimin e qymyrit gjer te sitat vibruese .
- Pluhurat të cilët lirohen në sitat vibruese për separimin (klasifikimin) e qymyrit.
- Pluhurat të cilët lirohen nga shiritat transportues për transportimin e qymyrit nga sitat vibruese gjer te silosët- bunkerët e thërmitoreve .

- Pluhuri i cili lirohet çdo herë gjatë thërrmimit të qymyrit, do të thotë te bunkerët-silosët, hinkat etj.
- Pluhurat të cilët lirohen gjatë transportit të qymyrit te thërrmuar, ne të gjitha hinkat , dhe shiritat transportues.
- Pluhurat të cilët lirohen nga deponit të cilët nevojiten për depozitimin e qymyrit.

5.2. Ndikimet në tokë

Ndikimet negative në tokë gjatë realizimit të procesit teknologjik për transportin, separimin- klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit mund të shkaktohen nga :

- Depozitimi i qymyrit .
- mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të pajisjeve dhe mekanizmave që nevojiten për realizimin e proceseve teknologjike për transportin, separimin- klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit, mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët.
- depozitimi i pluhurit i cili krijohet nga proceset teknologjike të cekura në pasusin e sipërm (ndikimet në ajër),
- mundësia e derdhjes së naftës gjatë mbushjes së rezervuarve dhe gjatë toçitjes së naftës , mundësia e shpërthimit të rezervuarve me naftë të vendosur mbi tokë
- mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e derivateve dhe vajrave nga makineria gjatë furnizimit me naftë dhe ndotja nga automjetet e punëtorëve.

5.3. Ndikimet në ujë

Ndikime negative në ujë gjatë realizimit të procesit teknologjik për transportin, separimin-klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit mund të shkaktohen nga:

- mundësia e derdhjes së naftës gjatë mbushjes së rezervarëve dhe gjatë toçitjes së naftës , mundësia e shpërthimit të rezervarëve me naftë të vendosur mbi tokë

- mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e derivateve dhe vajrave nga makineria gjatë furnizimit me naftë dhe ndotja nga automjetet e punëtoreve.
- pluhurat cilët krijohen nga proceset teknologjike të cekura në pasuset e sipërme ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore me rastin e të reshurave atmosferike si dhe në ndotjen e ujërave nëntokësore.
- mbeturinat e lëngëta , lubrifikantët e ndryshëm të cilat krijohen ne oficinën e riparimit te pajisjeve dhe mekanizmave që nevojiten për realizimin e proceseve teknologjike për transportin, seperimin- klasifikimin dhe thërrmimin e qymyrit.
- lubrifikantët e ndryshëm që derdhën nga pajimet dhe stabilimentet transportuese, separuese, thërrmuese si dhe nga mirëmbajtja dhe riparimi i tyre.
- Mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të pajisjeve dhe mekanizmave që nevojiten për realizimin e proceseve teknologjike për transportin, seperimin- klasifikimin dhe thërrmimin e qymyrit.
- ujërat e zeza.
- pluhuri i cili bartet me anë të ujërave sipërfaqësor etj.

5.4. Ndikimi në Peizazh

Lokacioni ku janë te vendosura pajisjet dhe mekanizmat që nevojiten për realizimin e proceseve teknologjike për transportin, seperimin- klasifikimin dhe thërrmimin e qymyrit., e ka marr pamjen e zonës industrial sepse është e vendosur në kompleksin Termocentralit për prodhimin e energjisë elektrike .

Peizazhi është i degraduar i cili me masat të cilat do të merren në mbarim të jetëgjatësisë së projektit, peizazhit do ti kthehet pamja në harmoni me gjendjen e përafërt të mjedisit rrethues. Këto masa do të arrihen me aplikimin e rikultivimit si masë për kompensim të shfrytëzimit.

5.5. Ndikimi në florë dhe faunë

Për shkak të proceseve operuese që zhvillohen në pajisjet dhe mekanizmat që nevojiten për realizimin e proceseve teknologjike për transportin, seperimin- klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit në gjatësinë kohore të operimit dhe në sipërfaqen operuese flora tërësisht është e shkatërruar, e cila duhet të rikultivohet pas përfundimit të punëve prodhuese. Fauna nuk do të dëmtohet fizikisht për arsye se do të largohen nga regjioni i veprimtarisë së lartë cekur dhe do të zhvillohet në terrenin e përafërt që i përshtatet faunës.

5.6. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Nga zhvillimi i aktivitetit të pajisjeve dhe mekanizmave që nevojiten për realizimin e proceseve teknologjike për transportin, seperimin- klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit në këtë lokalitet për shkak të pozitës dhe largësisë nga vendbanimet si që e kemi cekur në pasuset e më parme, nuk do të ketë nevojë të bëhet ç'vendosje e asnjë ndërtese banuese e as ndërtesave tjera ndihmëse.

Zhvillimi i veprimtarisë të pajisjeve dhe mekanizmave që nevojiten për realizimin e proceseve teknologjike për transportin, seperimin- klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit, për nevoja të prodhimit të energjisë elektrike në këtë lokalitet ka një rëndësi të veçantë për popullatën e këtij rejonit dhe tërë Kosovës.

Prandaj për të zhvilluar veprimtaria e lartcekur e vet ka të punësuar një numër të madh të punëtorëve, kryesisht nga popullata vendase.

Prandaj si u cek më lartë në aspektin e punësimit ka ndikime pozitive.

5.7. Ndikimet në Zhurmë

Zhurma, si element në teknologjinë e prodhimit ka një karakter lokal dhe pa ndikim në zonat e banuara. Zhurma vjen si rezultat i aktivitetit të procesit teknologjik, pajisjeve dhe mekanizmave që nevojiten për realizimin e proceseve teknologjike për transportin, seperimin- klasifikimin, thërrmimin e qymyrit.

Me shfrytëzimin e pajimeve prodhuese në bazë të standardeve të zakonshme maksimumi i zhurmës në burim është 90 dB.

Zhurma për zonën e banuar është plotësisht në kufijtë e standardit dhe nuk kalon 50 dB.

Pasqyrë tabelore e nivelit të zhurmës në varshmëri nga distanca jepet ne vijim.

Zhurma	Distanca (m)			
	10	50	100	500
90db –niveli	59	45	39	25
Për pajisje moderne				

5.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Pasi që aktiviteti i pajisjeve dhe mekanizmave që nevojiten për realizimin e proceseve teknologjike për transportin, seperimin- klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit janë mire të projektuara, të vendosura dhe të monitoruara nga ekspertët e lëmive përkatëse aksidente mjedisore të mëdha nuk mund të ndodhin. Aksidentet të cilat mund të ndodhin, mund të jenë të natyrës së ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo etapë të proceseve teknologjike në punishte si:

- Nga mundësia e lëndimet e punëtorëve gjatë kryerjes të aktiviteteve për realizimin e proceseve teknologjike për transportin, seperimin- klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit
- Nga mundësia e shpërthimit të rezervuarve me naftë të vendosur mbi tokë
- Nga mundësia e shkaktimit të zjarrit
- Nga mundësia e këputjes së shiritave transportues që nevojiten për transportin e qymyrit.

6. Marrja e Masave për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Ndikimeve

6.1. Masat e marruara për mbrojtjen e ajrit

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër të cilat i kemi cek më lart duhet ndërmarr këto masa: Pluhuri i cili lirohet në pajisjet dhe mekanizmat që nevojiten për realizimin e proceseve teknologjike për transportin, seperimin-klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit duhet të mënjanohet apo zvogëlohet gjerë në kufijtë e lejuar, që nuk do të ketë ndikime të mëdha për mjedisin. Për mënjanimin dhe zvogëlimin e sasisë së pluhurit kompania është e detyruar të bëj instalimin e sistemit të ujit për zvogëlimin e sasisë së pluhurit. Uji nëpër mjet gyp sjellësve sillet gjerë te thërrmueset e qymyrit dhe pajimet përcjellëse për transportimin dhe depozitimin e qymyrit. Sistemi i ujit për zvogëlimin e pluhurit i cili lirohet gjatë procesit të separimit dhe thërrmimit të qymyrit dhe pajimet përcjellëse për transportimin dhe depozitimin e qymyrit, duhet të vendoset në tëra stabilimentet të cilat lirojnë pluhur dhe atë shiritat transportues, në bunkerin/at pranues, në thërrmueset, në të gjitha hinkat dhe në të gjithë shiritat transportues . Në sistemin për zvogëlimin e pluhurit duhet vendosur valvulet për lëshimin dhe rregullimin e sasisë së ujit në mënyrë mekanike, gjithashtu duhet të vendosën diznet të cilat e lëshojnë ujin ne formë mjegulle e cila bënë ujitjen e qymyrit, dhe në këtë mënyrë qymyri i cili do të transportohet, separohet, thërrmohet, transportohet dhe bëhet depozitimi i qymyrit të ujitet ashtu që nuk mundë të lirohet pluhuri. Uji i cili shërben për mënjanimin e pluhurit duhet të rregullohet ne sasi vetëm sa të bëj rrëzimin e grimcave të pluhurit që të mos shpërndahen ne mjedis, kjo sasi varret nga lagështia e qymyrit e cila transportohet, separohet, thërrmohet dhe transportohet .

Pluhuri i cili lirohet gjatë realizimit të procesit teknologjik për transportin, seperimin-klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit nëse me instalimet e sistemit të ujit nuk mund të mënjanohet apo zvogëlohet gjerë në kufijtë e lejuar, që nuk do të ketë ndikime të mëdha për mjedisin, duhet ter shiritat transportues e posaçërisht shiritat transportues duhet të mbulohen dhe ne vend rrjedhje të materialeve duhet të ndërtohen hinkat.

Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik gjatë realizimit të procesit teknologjik për seperimin- klasifikimin dhe thërrmimin e qymyrit nëse me instalimet e sistemit të ujit dhe masat e lartë cekura nuk mund të mënjanohet apo zvogëlohet gjerë në kufijtë e lejuar, që nuk do të ketë ndikime të mëdha për mjedisin. Kompania duhet ber instalimin e sistemit të depluhurimit me anë të filterve që është sistem i avancuar për zvogëlimin e pluhurit.

Ne vijim po bëjmë përshkrimin e procesit teknologjik të depluhurimit. Pluhuri i cili krijohet gjatë procesit teknologjik thithet nga stabilimentet me ndihmën e ajrit përmes gypave që do të montohen në vendet ku krijohet pluhuri. Sasia e ajrit të thithur do të caktohet në bazë të përvojës dhe matjeve të bëra në pajimet e vendosura për shpluhrosje. Në çdo vend për shpluhrosje do të ekzistojnë flutura rregulluese me të cilën rregullohet sasia e ajrit të thithur. Të gjithë gypat do të jen ashtu të dimensionuar sa që shpejtësia e ajrit në ta është mjaft e madhe sa që nuk do të ketë palosje (fundërrim, ngjitje) të pluhurit në gypa. Të gjithë gypat thithës do të jenë të lidhur me gypin kryesor mbledhës të pluhurit i cili është i kyçur në filtrin OVF 350. Në vendet lidhëse të gypave vendosen mbyllësit e gomës të cilët shërbejnë si mbyllës e një herit edhe si izolator të ajrit. Në filtrin me thasë prej bezi nga ajri i ndotur ndahet gati e tërë sasia e pluhurit d.m.th. bëhet filtrimi i ajrit përmes bezit filtrues. Efekti i kësaj ndarje është mbi 99 %. Koncentrimi i pluhurit në dalje nga filtri sillet nën 50 mg/m^3 e që është më pak se e lejuara 150 mg/m^3 . Filtri i bezit është i pajisur edhe me stabilimente për pastrimin e thasëve, përndryshe shtresat e pluhurit do të pengojnë krejtësisht filtrimin dhe punën e të gjitha pajimeve ose stabilimenteve. Pastrimi bëhet me ventilatorin për fryrje i cili me ndihmën e një mekanizmi largohet prej thesi në thes dhe bënë fryrjen e thasëve me lëvizjen e ajrit nën shtypje. Lëvizja e ventilatorit për fryrje prej thesit në thes dhe koha e pauzës në mes thasëve caktohet me ndihmën e releut kohor në programaturën e filtrit. Ajri i pastruar nga filtri kalon përmes gypave në ventilatorin kryesor dhe prej aty në oxhak dhe del nga sistemi për shpluhërosje.

Pluhuri i ndarë në filtër largohet me kërmill dhe hyn në dozatorin e transportierit pneumatik prej aty me ndihmën e ajrit të komprimuar transportohet në silose. Siloset janë të pajisur me nivelues të cilët regjistrojnë nivelin maksimal në silose. Zbrazja e siloseve bëhet me ndihmën e stabilimenteve për mbushje me dorë ose mekanike i cili kyçet në

autocisternë. Për rrëzimin e pluhurit të shtresuar në pjesën konike të silosit bëhet me ajër të komprimuar. Kërmilli i pjerrët transportues i cili transporton pluhurin nga pjesa e poshtme e filtrit ku grumbullohet pluhuri ka një hapje plotësuese e cila shërben për pastrimin e tij.

Pajimet për shpluhrosje duhet të përbëhen nga këto elemente:

- a. filtri me thasë, me bëz të thatë,
- b. ventilator e filtrit
- c. ventilatorët centrifugal
- d. gypat, laka, reduktor, flutura rregulluese, ndarës dhe oxhaku
- e. transportieri pneumatik
- f. siloset

Pajimet dhe vendet ku duhet bërë largimi i pluhurit gjegjësisht pajimet për shpluhrosje do të vendosen :

- në të gjitha thërmueset
- në hinkat për derdhje të materialit

Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër, gjatë realizimit të procesit teknologjik për transportin, seperimin- klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit, përpos masave të lartë cekura duhet ndërmarr edhe këto masa:

- Duhet të bëhet mirëmbajtja e rregullt e pajimeve gjatë realizimit të procesit teknologjik për transportin, seperimin- klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit e posaçërisht stabilimenteve të cilat janë burim i emisioneve të pluhurit.
- Duhet të bëhet mirëmbajtja e rregullt e sistemit të instaluar për zvogëlimin e pluhurit me ujë dhe pastaj me filtër .
- Duhet të bëhet kontrollimi i rregullt i thasëve filtrues të dëmtuarit të ndërrohen.

- Gjithmonë duhet të bëhet spërkatja e sipërfaqeve manipuluese, dhe qymyrit të deponuar në depon për deponimin e qymyrit, sidomos gjatë kohës me erëra dhe temperatura të larta.
- Duhet të jetë çdo herë në disponim auto cisterna me ujë për spërkatje.
- Duhet të bëhet matja e emisioneve dhe imisioneve të pluhurit gjatë punës në punishte dhe në territorin më të gjer, duke iu përmbajtur të gjitha masave të cekura më lartë për mbrojtjen e ajrit, me qëllim të caktimit të sasisë së përbërjes së thërmijave të pluhurit, dhe për të krahasuar vlerat e matura me vlerat kufitare të caktuara.

6.2. Masat e marrura për mbrojtjen e tokës

Me qëllim të ruajtjes së tokës nga ndikimet negative gjatë realizimit të procesit teknologjik për transportin, seperimin- klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit, duhet ndërmarr këto masa:

- Duhet në mënyrë të rregullt të mirëmbahen stabilimentet për realizimin e procesit teknologjik për transportin, seperimin- klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit.
- Platoja dhe sipërfaqet operationale ku bëhet mirëmbajta (servisimi) i stabilimenteve për transportin, separimin- klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit të betonohet dhe izohet.
- Për të zvogëluar mundësin e rrezikut nga rrjedhjet e mundshme të naftës nga rezervariët rekomandohet që rezervarët me naftë të rrethohen me mur statik.
- Tëra sipërfaqet ku janë të vendosur rezervarët e naftës, si dhe sipërfaqet ku bahet manipulimi me naftë dhe sipërfaqet ku bëhet deponimi i vajrave dhe lubrifikanteve duhet të mbulohen me beton dhe të izohen.
- Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë realizimit të procesit teknologjik për transportin, seperimin- klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit, duhet të grumbullohen dhe klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre,

ato metalike të deponohen në vende të posaçme, ato të cilat nuk përdoren për nevoja të kompanisë ti shiten kompanive të licencuara.


- Mbeturinat e ngurta komunale të grumbullohen dhe vendosen në kontejner të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, me transport vetanak apo nëpërmjet ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponin e Mirashit.
- Depoja ku deponohen lubrifikantet e të thuret me mur statik si dhe platoja (dyshemeja) të betonohet, ne te të vendoset sistemi i bartjes së ujërave gjer ne Separator të vajrave .

6.3. Masat e marrura për mbrojtjen e ujit

Në lokalitetin e stabilimenteve për transportin, seperimin- klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit duhet të bëhet sistemi për grumbullimin dhe bartjen e ujërave të ndotura të krijuara nga sipërfaqet operationale dhe ujërave nga të reshurat atmosferike, duhet ber kolektorët për grumbullimin dhe sistemin gypor për bartjen e ujërave të ndotura nga tëra sipërfaqet operationale të pajisjeve për seperimin- klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit, nga sipërfaqet ku janë të vendosur rezervarët e naftës, sipërfaqet ku bahet manipulimi me naftë, nga sipërfaqet e depos së lubrifikanteve dhe vajrave, sipërfaqet e oficinës për riparimin e pajisjeve dhe mekanizmave që nevojiten për realizimin e proceseve teknologjike për transportin, seperimin- klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit, ujërat e ndotura duhet të dërgohen për trajtim në puse sedimentuese për pastrimin e ujërave të ndotur me grimca të ngurta. Përpos sistemit të gypave duhet të ndërtohet edhe sistemi i kanalit rreth e përqark depos për deponimin e qymyrit, sipërfaqeve operationale për grumbullimin dhe bartjen e ujërave të ndotura gjerë në puset sedimentuese. Puset sedimentuese duhet të ndërtohen tri puse në madhësi 3x(5x4x2m) për sedimentimin e thërrmijave të ngurta. Pas trajtimit në puset sedimentuse uji orientohet për trajtim të mëtutjeshëm në impiantin (seperatorin) për pastrimin e ujërave të ndotur me pluhura të qymyrit, me derivate , vajrat dhe lubrifikues të cilat kanë rrjedh në sipërfaqet operationale, nga pajimet e punës, dhe automjete e punëtoreve, e pasandaj ujërat e trajtuara në separator të lëshohen në sistemin e kanalizimit. Duhet rregullisht të pastrohen puset sedimentuese dhe separatori i vajrave . Ujërat e zeza duhet

së pari të trajtohen në gropën septike e cila është e ndërtuar e pastaj të lirohen në recipient të pastërta. Gropa septike duhet të pastrohet nga kompanitë e licencuara. Separatori i vajrave duhet të ndërtohet në at mënyrë që të parashihet mundësia për matjen e sasisë dhe mostrim të ujërave të ndotura që shkarkohen në recipient. shema e trajtimit të ujërave të ndotura e paraqitur në vijim.

Skema teknologjike e trajtimit të ujërave



Duhet të bëhet matja e cilësisë të ujërave të shkarkuara, vlerat e fituara duhet të krahasohen dhe nuk guxojnë të jenë më të larta se vlerat e caktuara si pas Udhëzimit administrativ Udhëzimi Administrativ Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor. Rezultatet e fituara duhet të dorëzohen në MMPH, intervali i matjeve do të kryhet në bazë të përcaktimit me aktet ligjore dhe në bazë të marrëveshjes me MMPH.

6.4. Masat e marrura për mbrojtjen nga zhurma

Duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtje nga zhurma. Matjet duhet bërë në afërsi të objekteve të banimit. Për analizat dhe vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet të krahasojmë me vlerat e lejuara me standarde për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit.

Në rast se zhurma e mesit nga matjet tejkalon at të lejuarën atëherë duhet të merren të gjitha masat që niveli i zhurmës të bihet në nivelin e lejuar sipas rregullave në fuqi.

Në varshmëri nga fazat e procesit të punës duhet edhe të punësuarit në ato vende të punës të përdorin mjetet kundër zhurmës.

6.5. Masat e marrura për mbrojtjen nga rreziqet aksidenciale

Për të evituar rreziqet aksidenciale duhet ndërmarr këto masa:

- Duhet të bëhet plani i intervenimit për raste të aksidenteve ekologjike.
- Duhet të bëhet plani i mbrojtjes nga zjarri.
- Për të zvogëluar mundësinë e rrezikut nga derdhja e naftës nga rezervarët preferohet që rezervarët të rrethohen me mur statik, në mënyrë që në raste të dëmtimit të rezervuarve ta nxënë tërë sasinë e naftës brenda mureve.
- Është obligim që rezervarët për naftë të kontrollohen çdo 5 viteve të punës për të përcjell dëmtimet e trashësisë së mureve nga veprimi korroziv.
- Të merren të gjitha masat për evitimin e derdhjes së derivateve të naftës dhe vajit nga makineritë e rënda.
- Duhet i tëra sipërfaqet operationale dhe pajisjet për transportin, separimin-klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit të thuret me tel gjembor.
- Të merren të gjitha masat e sigurisë konform ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mjedisit të punës.

7.0. Programi i Monitorimit

Ndikimet direket nga aktiviteti i Impiantit Separacioni “B”, gjegjësisht nga aktiviteti i pajisjeve për transportin, separimin-klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit bazuar në vlerësimet e ndikimit në mjedis janë ndikimet në tokë, ajër, ujë, flore-faune dhe zhurmë, për këtë arsye propozohet të punohet dhe pastaj të realizohet një program monitorues për të gjitha shkarkimet që vijnë nga veprimtaria e Separacionit.

Monitorimi i ajrit dhe ujit duhet të bëhet në perioda të caktuara periodike në konsultim me ekspert të kësaj lëmie dhe të jenë të pranueshme nga MMPH, Agjensioni Kombëtar i Mbrojtjes së Mjedisit – ku edhe duhet të raportohen të dhënat, ky monitorim realizohet me marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave në institute adekuate. Kontrolli i

kontaminimit të tokës dhe verifikimi i nivelit të zhurmës dhe vibracionit po ashtu duhet të realizohet dhe të raportohet tek kompetentet.

8.0 Raportimi

Do të kryhet nga udhëheqja, gjegjësisht nga ekspertët e DPQ – Separacioni “B” së paku një here në muaj, dhe në fund të vitit ku do të paraqiten të dhënat relevante nga të gjitha monitorimet e bëra brenda vitit, të cilat do të raportohen autoriteteve përkatëse të MMPH sipas kërkesës së tyre dhe komunitetit lokal brenda komunës.

9.0. Marrja e Masave Rehabilituese pas Përfundimit të Aktiviteteve Prodhuese

9.1. Objektivat e rikultivimit

Pas përfundimit të jetë gjatësisë së pajisjeve për transportin, seperimin- klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit, e kjo varret nga rezervat e shfrytëzuara të qymyrit. Pas këtij afati pajisjet për transportin, seperimin- klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit, duhet të çmontohen e të vendosen në një lokalitet tjetër apo në bazë të leverdis së kompanisë të shitën si material i vjetruar. Bazamentet si dhe platot nga betoni të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponi rajonale.

Nga proceset teknologjike të pajisjeve për transportin, seperimin- klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit do të krijohen substrate që i takojnë kategorisë së tokave të dëmtuara d.m.th. substrate të pa përshtatshme (sterile) për rikultivim. Substrate me përbërës të qymyrit, që pa tjetër duhet të largohen dhe bëhet zëvendësimi i tij me atë rrethit ashtu që të krijohet një substrat produktiv i përshtatshëm për rikultivim. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga realizimi i projektit. Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga:

Qëllimi i rikultivimit i cili nënkupton që pas përfundimit të punëve në procesin teknologjik, sipërfaqeve të degraduara, prapë tu kthehet funksioni i saj primar (prodhimi i biomasës), dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem.

Planifikimi i shfrytëzimit të tokës, planifikohet që toka në lokacionin e pajisjeve për transportin, seperimin- klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit të kthehet në gjendje të përafërt me ambientin rrethues.

9.2. Struktura përfundimtare e sipërfaqeve

Pas përfundimit të punimeve minerare me rikultivimin teknik do të krijohet një profil i ri i tokës, e cila mund të përdoret edhe për nevoja tjera . Propozohet që rikultivimi në ngastrat ku janë të vendosura pajisjet për transportin, seperimin- klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit të bahet me mbjelljen e fidaneve të ndryshme (pemëve) frytë dhënëse.

9.3. Rikultivimi teknik

Në bazë të ligjeve të mjedisit çdo tokë e dëmtuar si shkas i aktiviteteve prodhuese, pas skadimit të afatit të shfrytëzimit ekonomik të projektit, investitori është i obliguar që tokës ti kthej pamjen e më pashme.

Në bazë të punimeve të kryera hartografike- pedologjike në sipërfaqet e degraduara, duhet studiuar llojet e dëmtimeve si dhe intezitetin dhe ndikimin e tyre në botën bimore e pastaj të shqyrtohen mundësit e sanimit të efekteve të pavolitshme si dhe rikultivimi i kësaj pjese. Gjatë rikultivimit teknik duhet të përvetësohet teknologjia e tillë që rikultivimi të kryhet. Me krijimin e sipërfaqes së lirë nga largimi i pajimeve dhe bazamenteve të betonit duhet të fillohet me dizajnimin teknik të hapësirës së lirë duke bërë përgatitjen e terenit për rikultivim teknik të sipërfaqes tokësore të degraduar.

Degradimi i tokës gjatë realizimit të projektit shkon deri në at masë sa bëhet zhdukja fizike e profilit pedologjik të tokës, prandaj për këtë fazë të rikultivimit propozojmë krijimin e profilit pedologjik të tokës në sipërfaqet e dëmtuara.

Për formimin e shtresës së sipërme sipërfaqësore produktive të tokës parashihet shtresimi i një shtrese të dheut prej 30cm gjer në 50cm.

9.4. Rikultivimi agroteknik

Pas fazës së rikultivimit teknik fillon faza e rikultivimit agroteknik e cila fazë starton me analizimin e substratit të krijuar, për të përcaktuar vetitë agrokimike dhe pedologjike. Në bazë të analizave të propozohen masat meliorative dhe agroteknike që do të aplikohen në këtë tokë të re. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga veprimtaria e procesit teknologjik për transportin, seperimin- klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit. Për të llogaritur numrin e fidaneve për tërë sipërfaqen që do të rikultivohet, duhet të kalkulohet me distancën në mes rendeve dhe distancën në rend.

$$N_f = S / a \times b \text{ ku janë;}$$

S - sipërfaqja,

a –distanca në mes rendeve

b –distanca në mes fidaneve.

Në rastin tonë propozojmë që të dy këto distanca të jenë nga 2 m. Në pjesët ku do të behët mbjellja e bimëve duhet të vendoset një shtresë e humusit prej 0.3- 0.5 m trashësi të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të bëhet ngjeshja e këtij substrati me qëllim që të jetë shtresa ma kompakte. Pas këtij operacioni duhet të bëhen vrimat në mënyrë të mekanizuar.

Thellësia e gropës duhet të jetë aq sa është i gjatë habitusi qendror i sistemit rrënjor të bimës, ndërsa gjerësia duhet të jetë e atillë që rrënjës t'i siguroj shtrirje sa më të lirë. Nëpër këto gropa duhet të hedhet 150 gr pleh mineral dhe pleh të djegur të shtallës e pastaj rreth bimës hidhet shtresa e dheut e cila duhet të jetë e ngjeshur sa më mirë. Të gjitha këto bimë duhet të kontrollohen me kujdes gjendja shëndetësore e fidanëve. Fidanët duhet të shoqërohen me ambullazh përkatëse ne momentin e blerjes. Nga sistemi rrënjor hiqen të gjitha pjesët e dëmtuara. Para se të mbillen fidanet, rrënjët e tyre duhet të zhyten në solucion prej bajage të freskët dhe argjili me qëllim që kjo përzierje të shërbejë si ushqim fillestar për bimën, si dhe dheu të ngjitet sa më mirë për rrënje. Bima e përgatitur në këtë mënyrë është e gatshme për mbjellje. Koha më e përshtatshme për

mbjelljen e kulturave shumëvjeçare është vjeshta. Gjatë dimrit rrënja është aktive si dhe posedon sasi të optimale të lagështisë, kështu në pranverë bima ka një startim më të suksesshëm. Mirëmbajtjes së plantacionit të krijuar duhet kushtuar kujdes i veçantë sidomos në ujitje, prashitje, krasitje etj.

9.5. Rikultivimi biologjik

Qëllimi afatgjatë i rikultivimit biologjik është që të krijojmë ekosisteme të ri në hapësirat e dëmtuara në të cilën do të krijohet baraspeshë relative e të gjitha elementeve të ekosistemit siç janë: toka, flora, fauna dhe efekti ekonomik në prodhimtarin bujqësor, blegtorale dhe në silvokulturë. Rikultivimi biologjik është faza përfundimtare me të cilën arrihet edhe qëllimi i rikultivimit. Bimët të cilën e kemi propozuar në këtë projekt në sipërfaqet e degraduara janë fidanet e ndryshme (pemëve) frytë dhënëse. Edhe pse janë propozuar këto bimë, duhet të bëhet konsultimi me ekspertët profesional të Ministrisë së bujqësisë dhe Pylltarisë si dhe me të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

10. Monitorimi pas Shfrytëzimit

Pas përfundimit të aktiviteteve teknologjike të paisjeve për transportin, separamin-klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit, pushon edhe emetimi i pluhurit dhe i ndikimeve tjera në mjedis. Prandaj nuk paraqitet nevoja për vazhdimin e monitorimit të këtyre ndikimeve. Por DPQ – Separacioni “B” ka për detyrë të bëjë monitorimin e sipërfaqeve të rekultivuara, posaçërisht pjesës së pyllëzuar (mbjelljes së fidaneve fryt dhënëse) për një kohë të caktuar në bazë të marrëveshjes me Ministrinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë dhe Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

11. Konkluzion

Siç është shpjeguar në paragrafet e epërm të dhënat mjedisore dhe zhurma duhet konsideruar si problem që ka ndikim negative në shëndetin dhe mirëqenien e të punësuarve në Separacionin “B” dhe komunitetin për rreth Zonës Industriale të KEK-ut. Indikacionet e pakta në dispozicion tregojnë mundësi të tejkalimit të standardeve të imisionit të zhurmës (BE, BB) në zonat e banimit përreth kufirit të mihjeve nga një herë edhe në zonat banesore afër “Kosovës B”.

Ndikimi i pajisjeve për transportin, seprimin- klasifikimin, thërrmimin dhe deponimin e qymyrit në Mjedis, duhet të jetë në nivelin e vlerave të rekomanduara nga Ligji për Mbrojtjen në Mjedis **Nr. 03/L-025**, Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214 dhe ligjet e aktet tjera nënligjore relevante për mjedis. Ndikimet në tokë, ujë dhe në ajër rregullisht duhet të kontrollohen. Këto ndikime do të monitorohen dhe do të raportohen në fund të çdo viti kalendarik. Pas identifikimit dhe zbatimit të gjitha masave mbrojtëse të rekomanduara në këtë raport, konstatohet se ato mund të minimizohen në nivel të lakmueshëm, edhe të eliminohen tërësisht në fazën e rehabilitimit të hapësirave të degraduara gjatë ndërtimit dhe realizimit të projektit. Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme dhe i mundësojnë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, dhënien e mendimit për Pëlqim Mjedisor sipas kërkesës së KEK-ut Obiliq.

Shiriti transportues i qymyrit nga teleskopia (ndarja ne dy Seperacionet A + B) deri te Seperacioni B dhe deponia e qymyrit



This document was created with Win2PDF available at <http://www.daneprairie.com>.
The unregistered version of Win2PDF is for evaluation or non-commercial use only.